

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI JURIDIK

DREJTIMI PENAL



PUNIM DIPLOME MASTER

TEMA: PARABURGIMI NË VËSHTRIM KRAHASUES KOSOVË - MALI I ZI

Mentor: Prof. dr. AZEM HAJDARI

Kandidate: LAURA KUKAJ

PRISHTINË, JANAR 2024

ABSTRAKT

Për një shqyrtim gjithëpërfshirës të paraburgimi, si masë më e rëndë për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale, në raste të caktuara dhe konkrete është i nevojshëm dhe i domosdoshëm për mbarëvajtjen e procedurës penale. Rrjedhimisht, paraburgimi si masa më e rëndë për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale, mund të caktohet në momentin kur ekzistojnë dyshime të forta për një krim ose shkelje, me ç'rast për caktimin e paraburgimit duhet plotësuar kriteri i përgjithshëm i ekzistimit të dyshimit të bazuar se është kryer veprë penale dhe ekzistimi i rrezikut të arratisjes, rrezikut të shkatërrimit të provave ose rrezikut të përsëritjes së veprës penale me anë të të cilave specifikohet qartë rëndësia dhe qëllimi i paraburgimit.

Paraburgimi si masë më e rëndë për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale është një praktikë e rëndësishme, me ç'rast me anë të paraburgimit bëhet kufizimi i lirisë së individit për një periudhë të caktuar. Ky proces është një mjet thelbësor për ruajtjen e rendit shoqëror, mbrojtjen e sigurisë publike dhe garantimin e drejtësisë. Duke larguar individë të rrezikshëm nga komuniteti, ndalimi mund të parandalojë krimin dhe të sigurojë një mjedis të kontrolluar për rehabilitim dhe trajtim. Për më tepër, ai mund të shërbejë si një pengesë kundër sjelljes kriminale duke demonstruar pasojat e shkeljes së ligjit. Gjithashtu, paraburgimi siguron që të akuzuarit të jenë të disponueshëm për gjykim dhe i pengon ata të ndërhyjnë në procesin ligjor dhe njëkohësisht ta pengojnë zhvillimin e rregullt të procesit. Një aspekt tjetër i rëndësishëm i paraburgimit është se ai funksionon si një pengesë për individët potencial që mund të përfshihen në sjellje kriminale. Pikërisht, frika nga caktimi i paraburgimit mund t'i largojë potencialët e shkeljes së ligjit nga shumë veprimtari kriminale dhe të ndihmojë kështu në zvogëlimin e shkallës së krimit në shoqëri

Rregullimi i paraburgimit në Republikën e Kosovës dhe Malin e Zi, karakterizohet me shumë ngjajshmeri dhe disa dallime. Sa i përket ngjajshmërive të legjislacionit që rregullon masën e paraburgimit mes Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi veçojmë kriteret e caktimit të paraburgimit, njoftimi në gjuhën që e kupton i paraburgosuri dhe detyrimi për të njoftuar privimin e lirisë, reduktimi në kohë sa më të shkurt i paraburgimit, e drejta në mbrojtje të detyruar dhe të drejtat dhe detyrimet e të paraburgosurit, ndërsa sa i përket disa nga dallimet në legjislacionin që rregullon masën e paraburgimit mes Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi veçojmë detyrueshmëria e caktimit të paraburgimit, trajtimi i ankesave kundër paraburgimit, kohëzgjatja e paraburgimit, vazhdimi i paraburgimit dhe procedura e ndërprerjes së paraburgimit.

Punimi më titull: “Paraburgimi në vështrim krahasues Kosovë – Mali i Zi” përbëhet nga pjesa hyrëse dhe katër kapituj.

Në pjesën hyrëse trajtohen objekti, rëndësia dhe arsyet e trajtimit të paraburgimit, metodologjia e punës dhe struktura e punimit.

Kapitulli i parë përmbanë vështrime të përgjithshme mbi paraburgimin, duke specifikuar në mënyrë teorike kuptimin, historikun dhe karakteristikat e paraburgimit, duke vazhduar me tej me përparësitë dhe mangësitë e paraburgimit si dhe paraburgimin në relacion me masat tjera të sigurimit të pranisë së të pandehurit në procedurë penale, ndërkaq kapitulli përmbillet me jurisprudencën ndërkombëtare lidhur me paraburgimin.

Kapitulli i dytë përmbanë rregullimin e paraburgimit sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, duke trajtuar fillimisht autoritetin për caktimin e paraburgimit, kriteret dhe procedurën e caktimit të paraburgimit, duke vazhduar me tej me kohëzgjatjen, caktimin, vazhdimin dhe ndërprejen e paraburgimit, ndërkaq kapitulli përmbillet me të drejtat dhe detyrimet e të paraburgosurit.

Kapitulli i tretë përmbanë rregullimin e paraburgimit sipas Kodit të Procedurës Penale të Malit të Zi, duke trajtuar fillimisht autoritetin për caktimin e paraburgimit, kriteret dhe procedurën e caktimit të paraburgimit, duke vazhduar me tej me kohëzgjatjen, caktimin, vazhdimin dhe ndërprejen e paraburgimit, ndërkaq kapitulli përmbillet me të drejtat dhe detyrimet e të paraburgosurit.

Kapitulli i katërt zhvillohet në atë mënyrë, që specifikon detajisht ngjajshmëritë dhe dallimet e paraburgimit në mes të Kosovës dhe Malit të Zi, rrjedhimisht ngjajshmëritë dhe dallimet bazuar në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës dhe Kodin e Procedurës Penale të Malit të Zi